



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Misioni në Kosovë

Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Decentralizimit dhe Komuniteteve

Spektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

RAPORT MBI RASTET E DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË

KORRIK 2007

PASYRA E PËRMBAJTJES

FJALORTHI

I. HYRJE

II. KORNIZA LIGJORE

III. SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA GJATË MONITORIMIT TË
PROCEDURAVE GJYQËSORE

- A. Vonesat në caktimin e seancave gjyqësore
- B. Përfaqësimi ligjor dhe mbrojtja sociale e të fëmijëve gjatë procedurave gjyqësore
- C. E drejta për gjykim publik
- D. Përbërja jo e duhur e trupit gjykues
- E. Arsyetimet e pamjaftueshme të vendimeve
- F. Problemet me ankesa: Dështimi në ekzekutimin e urdhëresave për mbrojtje dhe afatet e paqarta të paraqitjes së ankesave
- G. Dështimi i autoriteteve në ndjekjen e veprave penale të cilat paraqiten nga dhuna në familje

IV. KONKLUZIONE

V. REKOMANDIME

FJALORTHI

KEDNG	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
QPS	Qendra për punë sociale
Rregullorja	Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
LPK	Ligji i Procedurës Kontestimore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. HYRJE

Dhuna në familje zakonisht përkufizohet si dhunë e cila ngjanë brenda një vendbanimi privat ndërmjet bashkëshortëve ose individëve që bashkëjetojnë. Ndonëse në shumicën e rasteve të dhunës në familje viktimat janë gra, aktet e dhunës të kryera ndaj fëmijëve, burrave apo të moshuarve gjithashtu mund të bien në kategorinë e rasteve të dhunës në familje. Për shkak të natyrës “private” të kësaj dhune, intervenimi mund të jetë i vështirë. Në të vërtetë, ngurrimi për të raportuar rastet e dhunës në familje te autoritetet dhe natyra patriarkale e disa shoqërive mund të ndikojnë negativisht në reagimin e autoriteteve qeveritare ndaj këtyre praktikave. Megjithatë, përkundër këtyre pengesave, shtetet prapëseprapë e kanë për detyrë që në mënyrë efektive të parandalojnë dhe ndëshkojnë dhunën në familje.

Në përputhje me këtë detyrim më 9 maj të vitit 2003, në Kosovë është shpallur Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje, e cila trajton problemin e dhunës në familje, veçanërisht duke ua dhënë viktimave të dhunës në familje të drejtën për të kërkuar nga gjykatat civile masa të ndryshme mbrojtëse kundër kryerësit të supozuar. Ky raport trajton shqetësimet e identifikuar nga OSBE-ja në lidhje me Rregulloren dhe zbatimin e saj nga sistemi i drejtësisë.

Problemet kryesore të vërejtura nga OSBE-ja janë vonesat e paligjshme në marrjen e vendimeve për kërkesat për urdhra për mbrojtje dhe caktimi i seancave gjyqësore. Një gjë e tillë e pengon qëllimin e Rregullores dhe mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e palës së mbrojtur.

Një fushë tjetër problematike ka të bëjë me procedurat gjyqësore të dhunës në familje ku viktimat e supozuara apo dëshmitarët janë të fëmijët. OSBE-ja ka monitoruar raste ku përfaqësuesit e Qendrës për Punë Sociale (QPS) nuk marrin pjesë fare në seancat e dëgjimit që përfshijnë të fëmijët, ndonëse interesi më i mirë i fëmijës e kërkon një gjë të tillë.

Një tjetër shqetësim është mungesa e rregullave të qarta në Rregullore rreth asaj se a duhet që seancat gjyqësore mbi dhunën në familje të jenë publike ose jo. OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur përbërje jo të duhur të trupit gjykues dhe arsyetime të pamjaftueshme të vendimeve mbi dhunën në familje.

Për më tepër, OSBE-ja ka identifikuar shqetësimet lidhur me procedurat e ankimit në rastet e dhunës në familje. Në disa raste, gjykata në mënyrë të paligjshme ka shënuar në vendim se ankesa e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje. Veç kësaj, duhet të qartësohet afati përfundimtar për dorëzimin e ankesave në përputhje me Rregulloren.

Gjithashtu, OSBE-ja është e shqetësuar për dështimin e autoriteteve për të bërë ndjekje sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) të veprave të dhunës në familje ashtu siç kërkohet me ligj.

Në fund, OSBE-ja ka nxjerrë disa rekomandime për autoritetet relevante në mënyrë që të përmirësohen mangësitë e theksuara.

II. KORNIZA LIGJORE

Meqë shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra dhe fëmijë, zakonisht ky problem trajtohet nga instrumentet ndërkombëtare që mbulojnë të drejtat e njeriut të grave dhe fëmijëve. Në këtë kontekst, Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG)¹ dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)² janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.³

KEDNG-ja nxit shtetet që “përmes të gjitha mënyrave të duhura dhe pa vonesë të ndjekin politikën e eliminimit të dhunës ndaj grave” dhe të “ushtrojnë kujdes të duhur për parandalimin, hetimin dhe, në pajtim me ligjet vendore, ndëshkimin e akteve të dhunës ndaj grave, pavarësisht nëse ato vepra janë kryer nga shteti apo nga personat fizik.”⁴ Në interpretimin e KEDNG-së, Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave konstatoi se dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe se “shtetet gjithashtu mund të mbahen përgjegjëse për aktet private nëse dështojnë të veprojnë me kujdes të duhur në parandalimin e shkeljeve të të drejtave apo në hetimin dhe ndëshkimin e akteve të dhunës, si dhe në sigurimin e kompensimit.”⁵

KDF-ja thekson se ndalohet çfarëdo lloj dhune ndaj fëmijëve dhe kërkon nga shtetet që të nxjerrin “tërë legjislacionin e duhur (...) për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, lëndimeve apo abuzimeve, lënies pas dore apo trajtimit mospërfillës, keqtrajtimit apo shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, gjatë kujdesit të prindërit(ve), kujdestarit(ve) ligjor apo personave tjerë të cilët kujdesen për fëmijën.”⁶

Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) kërkon nga shtetet që t’i ndërmarrin masat e nevojshme për të luftuar dhunën në familje. Ndalea në nenin 3 të KEDNj-së e cila thotë se askush nuk do t’i nënshtrohet torturës apo trajtimit dhe ndëshkimit poshtërues në kombinim me nenin 1, e cila i detyron shtetet që të sigurojnë që të gjithë personat brenda juridiksionit të tyre të gëzojnë të drejtat dhe

¹ Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (KEDNG) është miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 34/180 më 18 dhjetor 1979.

² Konventa për të drejtat e fëmijës (KDF), e miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 44/25 më 20 nëntor 1989, ka hyrë në fuqi më 2 shtator të vitit 1990.

³ Shih nenin 3(2) (c), (e), (f) dhe 3(3) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9, më 15 maj 2001, dhe e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/9.

⁴ Neni 4 i KEDNG-së.

⁵ Shih Rekomandimin e Përgjithshëm 19 të Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, (organi i traktatit që mbikëqyrë përputhshmërinë e shteteve me KEDNG-në) i miratuar në vitin 1992. Komiteti më tutje ka rekomanduar masat në vijim të cilat duhet të ndërmerren nga shtetet për të ofruar një mbrojtje efektive të grave ndaj dhunës: “masat efektive juridike, përfshirë sanksionimet penale, mjetet juridike civile dhe dispozitat e kompensimit për mbrojtjen e grave ndaj të gjitha llojeve të dhunës” dhe “masat mbrojtëse, përfshirë refugjatët, këshillimin, veprimet rehabilituese dhe shërbimet përkrahëse për gratë që janë viktimat të dhunës apo që janë në rrezik nga dhuna.” (Neni 24(t) (i) dhe (iii)). Shih po ashtu mendimet e Komitetit të miratuara më 26 janar 2005 në lidhje me rastin *A.T. kundër Hungarisë, Komunikata nr. 2/2003*, ku Komiteti vendosi që për shkak të mungesës së masave efektive ligjore dhe të tjera, Hungaria ka dështuar të ofrojë mbrojtje efektive kundër dhunës në familje dhe në këtë mënyrë ka shkelur të drejtat e garantuara nga KEDNG-ja (shih nenet 9.1-9.6 të mendimeve të paraqitura në janar 2005). Këto mendime të Komitetit janë lëshuar në pajtim me Protokollin Opcional të KEDNG-së, të miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A/54/4 më 6 tetor 1999.

⁶ Neni 19 i KDF-së.

liritë e përkufizuara në KEDNj, iu imponon shteteve detyrim afirmativ për parandalimin e torturës apo sjelljes poshtëruese e cila ndodh në kontekstin familjar. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), neni 3 kërkon nga autoritetet publike që të ndërmarrin masa adekuate për të siguruar që individët të mos i nënshtrohen trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës (përfshirë dhunën në familje) nga personat fizik.⁷ Korniza ligjore duhet t'i mbrojë viktimat në situata të tilla.⁸

Këto traktate ndërkombëtare plotësohen me instrumente tjera. Ndonëse nuk janë ligjërish të detyrueshme, instrumentet përcaktojnë standardet dhe shtjellojnë parimet për luftimin e dhunës në familje. Për shembull, Deklarata për eliminimin e dhunës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1993 kërkon që shtetet anëtare të ndjekin, përmes të gjitha masave të duhura, politikën e eliminimit të dhunës ndaj gruas.⁹ Gjithashtu, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka adresuar çështjen e dhunës në familje ndaj grave përmes disa rekomandimeve dhe rezolutave.¹⁰ Në mënyrë më specifike, në Rekomandimin 1582 (2002), Asambleja nxit shtetet anëtare që të pranojnë se kanë për obligim parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e të gjitha akteve të dhunës në familje dhe të mbrojnë viktimat e dhunës në familje.¹¹

Në Kosovë, dhuna në familje nuk përbën veprë të veçantë penale. Megjithatë, Rregullorja kërkon që veprat penale të lëndimeve të lehta trupore dhe dëmet pronësore të "ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare" nëse ato kryhen në kontekst të marrëdhënies familjare.¹² Veç kësaj, në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK),¹³ disa vepra penale mund të ndëshkohen me dënime më të larta nëse janë kryer kundër personit me të cilin kryesi i veprës ka marrëdhënie familjare.¹⁴

⁷ A. kundër Britanisë së Madhe, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GjEDNj), aktgjykimi i 23 shtatorit 1998, par. 22; Z. kundër Britanisë së Madhe, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 10 maj 2001, par. 73; shih gjithashtu Raportin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë: *Lidhur me zbatimin e nenit 7 dhe nenit 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje* të datës 23 nëntor 2006, par. 21 deri 31.

⁸ A. kundër Britanisë së Madhe, shih *po aty.*, para. 24.

⁹ Neni 4 i Deklaratës për eliminimin e dhunës ndaj grave, të miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme nr. 48/104 më 20 dhjetor 1993.

¹⁰ *Mes tjerash*: Rekomandimi nr. 1450 (2000), *Dhuna kundër grave në Evropë*; Rekomandimi nr. 1523 (2001), *Skllavëria në familje*; Rekomandimi nr. 1582 (2002), *Dhuna në familje kundër grave*; Rekomandimi nr. 1663 (2004), *Skllavëria në familje: robëria, puna si shërbëtoresh dhe nuset e porositura me postë*; Rekomandimi nr. 1681 (2004), *Fushata për luftimin e dhunës në familje kundër grave në Evropë*.

¹¹ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rekomandimi nr. 1582 (2002), par. 4. Shembuj tjerë të instrumenteve jo-detyruese: Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1325 (2000) kërkon nga autoritetet që të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në baza gjinore; Këshilli për çështje ekonomike dhe sociale (ECOSOC) është pajtuar për *Udhëzimet për çështjet e drejtësisë që përfshijnë fëmijët që janë viktimat dhe dëshmitarët të veprave penale* (Rezoluta e ECOSOC-së nr. 2005/20, 22 korrik 2005); *Përfundimi i Samitit të OKB-së në vitin 2005*, përfshinë marrëveshjet për fuqizimin e kapaciteteve kombëtare për përmirësimin e situatës së fëmijëve të cilët iu janë nënshtuar dhunës në familje (shih Dokumentin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A/60/L.1 të datës 15 shtator 2005, par. 141).

¹² Nenet 16(2) dhe 16(3), të Rregullores.

¹³ Kodi i përkohshëm penal i Kosovës (KPPK), i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25, më 6 korrik 2003 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/19.

¹⁴ Ky rast ka të bëjë me veprat penale në vijim: lëndimet e lehta trupore (neni 153(4) KPPK), lëndimet e rënda trupore (neni 154(3), KPPK), kërcënimi (neni 161(3), KPPK), heqja e paligjishme e lirisë (neni 162(4), KPPK), dhunimi (neni 193(3) 8), KPPK), sulmi seksual (neni 195(3) 8), KPPK, dhe veprat kundër integritetit seksual neni 196(3) 7), KPPK). Për definicionin e marrëdhënies familjare në KPPK, shih nenin 107 (2)(24), KPPK.

Rregullorja, e cila ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2003, parasheh një procedurë të civile, sipas së cilës viktimat e dhunës në familje¹⁵ mund të parashtrorë kërkesë për urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente, ose urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme.¹⁶

Rregullorja përmban një listë gjithëpërfshirëse të veprave apo shkeljeve të cilat mund të bien në kategorinë e dhunës në familje, nëse kryhen kundër një personi me të cilin kryerësi është apo ka qenë në marrëdhënie familjare.¹⁷ Marrëdhënia familjare është e definuar gjerësisht sipas Rregullores si marrëdhënie mes dy individëve të cilët janë të fejuar, të martuar apo bashkëjetojnë pa kurorëzim, të cilët ndajnë një shtëpi dhe kanë lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, axhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë ose ata që janë prindër të fëmijës së përbashkët.¹⁸

Rregullorja gjithashtu përmban një listë masash që mund të përdoren në urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente dhe urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme.¹⁹ Ajo thekson se shkelja e urdhrave të tillë përbën vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).²⁰

Përfundimisht, ekziston e drejta për ankesë kundër vendimit për urdhër për mbrojtje, ose kundër konfirmimit të urdhrit për mbrojtje emergjente. Ankesa duhet të parashtrohet në afat prej tetë ditëve nga lëshimi i vendimit, ndonëse ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit.²¹

¹⁵ Përveç palës së mbrojtur, Rregullorja gjithashtu u mundëson personave/institucioneve tjera të parashtrorë kërkesë për urdhëresë për mbrojtje apo urdhëresë për mbrojtje emergjente. Shih nenet 6 dhe 13 të Rregullores.

¹⁶ Urdhëresa për mbrojtje mund të kërkohet nga gjykata kompetente kur parashtruesi i kërkesës frikësohet për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e palës së mbrojtur, neni 6(3) (d) i Rregullores. Për të lëshuar një urdhëresë për mbrojtje emergjente, kërcënimi ndaj sigurisë, shëndetit apo mirëqenies së palës së mbrojtur duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe i pashmangshëm. Shih nenin 10(1) b) të Rregullores. Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesat për urdhëresat për mbrojtje të përkohshme emergjente mund t'i paraqiten edhe organeve të zbatimit të ligjit. Këto urdhëresa të përkohshme pushojnë së vepruari në përfundim të ditës së ardhshme të punës të gjykatës. Neni 13 i Rregullores.

¹⁷ Vepra apo shkelje të tilla janë: Shkaktimi i lëndimit trupor; Marrëdhënia seksuale pa pëlqim ose keqtrajtimi seksual; Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike; Rrëmbimi; Shkaktimi i dëmeve pasurore; Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër; Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët; Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përlules së personit tjetër. Neni 1(2) i Rregullores.

¹⁸ Neni 1(1) i Rregullores.

¹⁹ Neni 2 i Rregullores. Për masat që mund të urdhërohen në një urdhëresë për mbrojtje, shih nenin 2(1) (a)-(p), urdhëresat për mbrojtje emergjente neni 2(1) (a)-(h), dhe për urdhëresën për mbrojtje të përkohshme, neni 2(1) (a)-(c), i Rregullores.

²⁰ Nenet 15 dhe 16 të Rregullores.

²¹ Neni 11 i Rregullores.

III. SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA GJATË MONITORIMIT TË SEANCAVE GJYQËSORE

Edhe pse Rregullorja dërgon porosi të qartë të mos-tolerimit të dhunës në familje, vetëm zbatimi i saj i efektshëm mund të zvogëlojë problemin e dhunës në familje në Kosovë. Kjo pjesë përqendrohet në brengat e identifikuar nga OSBE-ja në lidhje me Rregulloren dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga gjykatat në Kosovë.

A. Vonesat në caktimin e seancave gjyqësore

Problem i rëndësishëm i identifikuar nga OSBE-ja është vonesa e paligjshme në marrjen e vendimit mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje apo caktim të seancave gjyqësore. Këto vonesa jo vetëm që shkelin të drejtën vendore dhe ndërkombëtare, por edhe vetë qëllimin e urdhrave për mbrojtje.

Përderisa OSBE-ja ka raportuar mbi këtë problem edhe në të kaluarën,²² mospërfillja e afateve të parashkrimit nga gjykatësit për vendimet mbi kërkesat për urdhrat për mbrojtje meriton theksimin e përsëritur të problemit.

Sipas Rregullores, kërkesa për urdhër për mbrojtje duhet të vendoset brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës nga gjykata.²³ Kërkesat për urdhër për mbrojtje emergjente duhet të shqyrtohen brenda 24 orësh nga data e parashtrimit të kërkesës.²⁴ Në praktikë, gjykatat dështojnë të respektojnë afatet e përcaktuara me Rregullore. Rastet e dhëna më poshtë shërbejnë si shembuj.

Në një rast në Gjykatën Komunale të Prizrenit, pala e mbrojtur²⁵ parashtroi kërkesën për urdhër për mbrojtje më 30 qershor 2005, pasi pretendonte që burri i saj e kishte rrahur dhe i kishte shkaktuar lëndime.²⁶ Megjithatë, dëgjimi i parë ishte caktuar vetëm më 8 maj 2006, dhjetë muaj pas parashtrimit të kërkesës. Pastaj, kjo seancë përgatitore ishte shtyrë, në mënyrë që pala paditëse të mund të paraqes prova shtesë. Seanca përfundimisht u mbajt më 2 qershor 2006. Gjykata e hodhi poshtë rastin më 2 qershor 2006.²⁷

Në një rast në Gjykatën Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, pala e dëmtuar kërkoi masë mbrojtëse më 5 prill 2006, për vete dhe për tre fëmijët e saj. Pala pretendonte që burri i saj e kishte keqtrajtuar atë verbalisht dhe e kishte kërcënuar me dëbim nga shtëpia nëse ajo do ta njoftonte policinë. Edhe pse pala deklaroi se i padituri ia kishte thyer dorën të dëmtuarës dhe e kishte sulmuar atë fizikisht në incidente të mëhershme, gjykata caktoi dëgjimin e parë një vit më vonë, më 22 mars 2007.

²² Shih Raportet Mujore të Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, mars 2005 dhe gusht 2005. Që nga viti 2007, Departamenti ka ndërruar emrin, dhe tani është Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Decentralizimit dhe Komuniteteve.

²³ Neni 7(1) i Rregullores

²⁴ Neni 9 (1) i Rregullores

²⁵ Neni 1(6) i Rregullores definojnë "Palën e mbrojtur" si person i cili i është nënshtruar dhunës në familje dhe në favor të së cilit është kërkuar urdhëresa për mbrojtje.

²⁶ Pala e mbrojtur kërkoi që gjykata të lëshojë urdhëresat sipas nenit 2(1) (a) - (d) dhe (f), të Rregullores.

²⁷ Paditësi ka parashtuar një ankesë, e cila ende është në pritje.

Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale të Mitrovicës/Mitrovica, derisa pala e mbrojtur e kishte paraqitur kërkesën për urdhër për mbrojtje më 29 maj 2006, për shkak se sipas saj burri i saj e kishte sulmuar disa herë në shtëpi dhe e kishte kërcënuar ta vriste, gjykata nuk e kishte caktuar dëgjimin e parë deri më 27 qershor 2006. Gjykata e kishte shtyrë dëgjimin dy herë për shkak të problemeve në dorëzimin e thirrjeve.²⁸ Seanca gjyqësore përfundimisht është mbajtur më 21 korrik 2006. Gjykata e ka lëshuar urdhëresën për mbrojtje më 4 gusht 2006.

Në një rast në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, më 7 shkurt 2007 pala e mbrojtur kërkoi një urdhër për mbrojtje, pasi që sipas saj burri i saj e kishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht, dhe e kishte kërcënuar të vriste babanë dhe vëllezërit e saj. Gjykata caktoi dëgjimin e parë më 27 shkurt 2007. Gjykatësi pastaj e shtyu atë deri më 19 mars 2007, për shkak të vështirësive, sipas tij, për të thirrur palën e mbrojtur.

Këto vonesa të tepërta në rastet e dhunës në familje ngrenë brenga serioze, pasi që gjykatat nuk kanë respektuar afatet e kërkuara kohore për të marrë vendim mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje. Përderisa afati për shqyrtimin e kërkesës për urdhër për mbrojtje është 15 ditë, në shembujt më lart vendimet nuk janë marrë deri sa kanë kaluar gjashtë javë deri në gati një vit pas parashtrimit të kërkesës.

Qëllimi i afateve të shkurtra sipas Rregullores, për seancat gjyqësore mbi dhunën në familje është të mbrojë ata që janë në rrezik nga lëndimi.²⁹ Nëse kërkesat për urdhra për mbrojtje nuk trajtohen menjëherë, viktima e supozuar e dhunës në familje ballafaqohet me rrezikun e agresivitetit të mëtutjeshëm, si dhe dëmtimit fizik apo psikologjik që nga koha kur pala e mbrojtur parashtron kërkesën e deri në arritjen e vendimit nga gjykata. Pasi disa gjykata komunale nuk respektojnë afatet e përcaktuara me Rregullore, gjykatat në Kosovë dështojnë në mbrojtjen e viktimave të mundshme të dhunës në familje. Megjithatë, gjykatat jo vetëm që shkelin të drejtën vendore, por edhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat kërkojnë masa efektive për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje kundër trajtimit çnjerëzor apo poshtërues.

Përveç vonesave në caktimin e seancave gjyqësore dhe vendosjen mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje, OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur që gjykatësit dështojnë të vendosin mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje kur ekzistojnë procedura të njëkohshme të shkurorëzimit në mes të palëve të njëjta. Rasti në vijim shërben si shembull:

Më 8 maj 2006, pala e mbrojtur parashtrroi kërkesë për urdhër për mbrojtje në Gjykatën Komunale në Prishtinë/Priština për lejimin e shfrytëzimit të

²⁸ Rasti ishte shtyrë për shkak se i padituri nuk ishte thirrur në mënyrën e duhur, për shkak të problemeve me dorëzimin e thirrjeve në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica.

²⁹ Shih nenin 8(1) b) të Rregullores (Gjykatësi lëshon urdhëresën për mbrojtje nëse është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare); dhe neni 10(1) b) (Gjykatësi mund të urdhërojë mbrojtjen emergjente nëse i pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur).

vendqëndrimin të shfrytëzuar edhe nga pala e paditur (burri i saj), i cili sipas saj e kishte dëbuar atë më parë. Më 26 maj 2006, gjykata lëshoi urdhrin e kërkuar për mbrojtje, e cila u rrëzua me ankesë më datën 31 korrik 2006. Gjykata e apelit ktheu rastin në gjykatën e shkallës së parë për gjykim të serishëm. Megjithatë, gjykatësi i shkallës së parë nuk ricaktoi menjëherë seancën për çështjen e urdhrin për mbrojtje. Gjykatësi nuk caktoi seancën gjyqësore, me qëllim të pritjes së përfundimit të rastit të shkurorëzimit, i cili ishte iniciuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priština më 16 qershor 2006 nga burri i saj. Seanca e parë e rigjyimit mbi urdhëresën për mbrojtje u caktua përfundimisht më 7 dhjetor 2006, e cila u shty për shkak se përfaqësuesit e të dyja palëve propozuan të presin vendimin mbi rastin e shkurorëzimit i cili ishte në procedurë. Përfundimisht, rigjykimi mbi kërkesën për urdher për mbrojtje ndodhi me 6 shkurt 2007, kur çështja ishte ndërlikuar, pasi që apartamenti në fjalë ishte shitur më 20 tetor 2006.³⁰

Shembujt e përshkruar më lartë tregojnë që gjykatat nuk japin prioritet të mirëfilltë ose nuk zbatojnë ligjin përkatës në rastet e dhunës në familje. Dhe duke mos përmbushur afatet për marrjen e vendimit për urdhrat për mbrojtje, gjykatat e zbehin qëllimin e ligjit dhe rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e palës së mbrojtur.³¹

B. Përfaqësimi ligjor dhe mbrojtja sociale e fëmijëve gjatë procedurave gjyqësore

OSBE-ja gjithashtu është e brengosur për procedurat gjyqësore të dhunës në familje ku viktimat ose dëshmitarët e supozuar janë të miturit. KDF-ja ofron udhëzime juridike në procedurat gjyqësore ku përfshihen fëmijët. Porosia kryesore e KDF-së është që në të gjitha aktvendimet e autoriteteve publike – përfshirë gjykatat – që kanë të bëjnë me fëmijë, duhet që para se gjithash gjithmonë të marrin para sysh interesin më të mirë të fëmijës.³² Veç kësaj, neni 12 i KDF-së obligon që fëmijës t'i ofrohet mundësia që të dëgjohet në procedurat gjyqësore që prekin fëmijët, qoftë drejtpërsëdrejti, nëpërmjet përfaqësuesit ose një organi përkatës.³³

³⁰ Sipas nenit 5 të Rregullores, gjykatat komunale janë në përgjithësi kompetente për të shqyrtuar kërkesat për urdhrat për mbrojtje. Vetëm nëse ankesa në bazë të ligjit të aplikueshëm mbi marrëdhëniet martesore dhe familjare është parashtruar në një gjykatë kompetente atëherë kjo gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhëresë për mbrojtje (neni 5(3), i Rregullores). Megjithatë, në rastin në fjalë, kërkuesi fillimisht ka parashtruar kërkesën për urdhëresën për mbrojtje në gjykatën komunale, ndërsa pas kësaj, burri ka parashtruar kërkesën për shkurorëzim në gjykatën e qarkut. Pastaj, gjykata komunale kishte juridiksion për të vendosur mbi urdhëresën për mbrojtje, përderisa gjykata e qarkut ishte kompetente sa i përket shkurorëzimit. Nuk kishte ndonjë arsytim ligjor për vonesën e seancës gjyqësore mbi urdhëresën për mbrojtje derisa të zgjidhet rasti i shkurorëzimit.

³¹ OSBE-ja vëren që pas theksimit të këtij problemi në raportin e kaluar, disa gjykata kanë përmirësuar përputhshmëritë me Rregulloren. Për shembull, në një rast në gjykatën komunale në Mitrovicë/Mitrovica në të cilin parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar urdhëresë për mbrojtje më 11 shtator 2006, gjykata kishte lëshuar urdhëresë për mbrojtje katër ditë më vonë, më 15 shtator 2006. Në shembujt vijues të datave 12 shtator 2006, 12 janar 2007 dhe të 20 marsit 2007, Gjykata Komunale në Pejë/Peć kishte marrë vendim për kërkesat për urdhëresë për mbrojtje në afatin kohor të paraparë sipas Rregullores.

³² Fëmijë është çdo person i cili ende nuk ka mbushen moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.

Shiko Rregulloren e UNMIK 2003/12.

³³ Neni 12 i Rregullores. Krahas kësaj, Udhëzuesit OKB-së për Çështjet Gjyqësore ku përfshihen viktimat fëmijë dhe dëshmitarët e veprës penale përcaktojnë që viktimat duhet të kenë qasje në ndihmë

Rregullorja parasheh që si viktimë e supozuar, ashtu edhe i pandehuri mund të ndihmohen nga avokati në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me urdhrat për mbrojtje, urdhrat emergjente për mbrojtje, ose urdhrat e përkohshëm emergjentë për mbrojtje.³⁴ Veç kësaj, me pëlqimin e tij/saj, viktimë do të ketë një mbrojtës të viktimitave i cili i përfaqëson interesat e tij/saj në procedurat për urdhër emergjent të mbrojtjes.³⁵ Në rastet kur pala e mbrojtur është i fëmijë ose kur veprat e supozuara të dhunës në familje ndikojnë te i fëmijët, gjykata duhet të mbajë seancë dëgjimore ku mund të dëgjohet edhe përfaqësuesi i QPS-së. Gjykata menjëherë duhet ta thërras përfaqësuesin e QPS-së dhe të kërkojë nga ai person që të paraqes mendimin e vet me shkrim si vlerësim mbi situatën e palës së mbrojtur.³⁶

Veç kësaj, pasi që procedura e paraparë sipas Rregullores së UNMIK-ut është procedurë civile, dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK)³⁷ mund të zbatohen edhe në procedurat e dhunës në familje. Për shembull, njëra nga dispozitat e LPK-së që do të mund ishte e zbatueshme të thotë që “pala e cila nuk ka mundësi të fillojë procedurën, do të përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor.”³⁸

Në përgjithësi, prindërit kanë të drejtë dhe janë të obliguar që të përfaqësojnë fëmijët e tyre.³⁹ Megjithatë, në disa rrethana të veçanta, siç janë kontestet gjyqësore ku fëmija dhe prindërit janë palë në kontest, nuk do të ishte në interesin më të mirë të fëmijës që prindërit të veprojnë si përfaqësues të tij. Për shembull, neni 343 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Familjare parasheh që në kontestet në lidhje me vërtetimin ose refuzimin e atësisë, nëse fëmija dhe prindi i cili është përfaqësues ligjor i fëmijës kanë interesa të kundërta në kontest si paditës dhe i paditur, organi i kujdestarisë që është QPS-ja⁴⁰ do të caktojë një kujdestar të posaçëm për fëmijën.

efikase nga profesionistët që kanë kryer trajnime përkatëse. Shih Rezolutën e ECOSOC 2005/20, 22 korrik 2005, para. 22 *et seq.*

³⁴ Neni 4 i Rregullores. Kjo e drejtë për ndihmë nga këshilltari ligjor është i pakuptimtë në rastet kur viktimë e supozuar e dhunës në familje nuk mund të paguaj këshilltarin ligjor. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 mbi ndihmën juridike, 7 qershor 2006 (rregullorja për ndihmën juridike), e cila rregullon sistemin e ndihmës juridike për Kosovë, parasheh dispozitën e ndihmës juridike për të fëmijët. Është brengosës fakti që Rregullorja nuk ofron në mënyrë eksplicite ndihmën juridike për viktimitat e supozuara të dhunës në familje, por vetëm për çështjet e ndarjes, shkurorëzimit dhe ligjit mbi familjen (shih nenin 9 të Rregullores mbi ndihmën juridike). Për momentin, sistemi i ndihmës juridike nuk është funksional plotësisht.

³⁵ Neni 6 (6) i Rregullores.

³⁶ Neni 7 (2) (d) dhe 7.3 i Rregullores.

³⁷ Ligji mbi procedurën kontestimore (LPK), Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, dhe 35/91.

³⁸ Neni 80 i LPK-së. Fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara të veçanta janë shembuj të personave që iu mungon zotësia e veprimit për ta përfaqësuar veten në procedurat gjyqësore. Shih komentet për nenin 80 të LPK-së të bëra nga Tomislav Ralčić (gjyqtar i Gjykatës Supreme të Serbisë) dhe Vitoje Tanasković (gjyqtar i Gjykatës së Qarkut të Beogradit), të botuara nga Knjizevne Novine, Beograd 1980, faqe 162.

³⁹ Neni 133 i Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 2004/32 mbi Familjen, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/7 më 16 shkurt 2006 (Ligji mbi Familjen).

⁴⁰ Sipas nenit 6 të Ligjit mbi Familjen, organi i kujdestarisë është një organ komunal administrativ i cili është kompetent për çështjet sociale. Ky organ komunal administrativ është QPS-ja, siç përcaktohet në nenin 7 të Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-17 mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/46 më 14 tetor 2005 (Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare).

Sidoqoftë, Rregullorja nuk e qartëson se a është kërkesë e detyrueshme që QPS-ja të dëgjohet dhe të përfaqësojë interesat e fëmijës në rastet e dhunës në familje. Rregullorja në nenin 7 (2) vetëm parasheh që gjykata “do të mbajë seancën gjyqësore” në të cilën ‘mund të dëgjohet përfaqësuesi i QPS-së.’ Edhe pse formulimi i gjuhës është i dykuptimtë, neni duhet të interpretohet në përputhje me KDF-në, në mënyrë që të ketë kërkesë të detyrueshme për të dëgjuar QPS-në nëse një gjë e tillë kërkohet për shkak të interesit më të mirë të fëmijës. Kjo do të ndodhte në shumicën të rasteve të dhunës në familje, posaçërisht kur njëri nga prindërit supozohet se ka kryer vepër të dhunës në familje. Në këto raste, zakonisht janë në pyetje interesat e kundërta ndërmjet prindërve dhe fëmijës. Veç kësaj, QPS-ja ka përgjegjësi të sigurojë mbrojtjen e fëmijës dhe të ofrojë mbrojtje të tij, kujdes social ose këshillime nëse fëmija është duke vuajtur nga pasojat e konfliktit familjar.⁴¹ Pastaj, QPS-ja duhet të mbrojë interesat e fëmijës në procedurat e dhunës në familje. Kjo mund të ndihmojë që të sigurohet që fëmijët të paraqesin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me ta.

Vlen të përmendet që sipas nenit 7 (3) të Rregullores, gjykata duhet “menjëherë të thërret” një përfaqësues dhe të kërkojë raport me shkrim. Në rastet e tilla, QPS-ja duhet të ofrojë një vlerësim të ekspertit për rrethanat sociale të personit relevant dhe të bëjë rekomandime për mirëqenien e tyre të ardhme brenda njëzetë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.⁴²

Sidoqoftë, OSBE-ja ka monitoruar raste ku përfshihen fëmijët dhe ku gjykata kishte dështuar të thërras një përfaqësues nga QPS-ja, ose përfaqësuesit e thirrur të QPS-së kishte dështuar të paraqiten në seancë gjyqësore ku gjykata prapëseprapë kishte vazhduar me procedurat:

Në një rast të dhunës në familje në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, nëna kishte kërkuar urdhrë për mbrojtje më 29 shtator të vitit 2006 për veten e saj dhe për djalin e saj foshnje për arsye të lëndimeve të supozuara psikologjike dhe fizike të shkaktuara nga i padituri.⁴³ Ajo gjithashtu kishte kërkuar që t’i lejohet të kthehet në të njëjtin bllok banesor ku ishte i padituri. Edhe pse gjykata kishte thirrur përfaqësuesin e QPS-së për të marrë pjesë në seancën e 13 tetorit 2006, përfaqësuesi i QPS-së nuk ishte paraqitur në seancën gjyqësore. Prapëseprapë, gjykata kishte vazhduar seancën dhe kishte lëshuar urdhrin e kërkuar për mbrojtje.⁴⁴

Në një rast tjetër të dhunës në familje në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, më 1 shkurt të vitit 2006 paditësja/bashkëshortja kishte ikur së bashku me dy fëmijët e saj nga banesa e përbashkët, për shkak se burri i saj e kishte sulmuar atë. Sipas urdhrin të propozuar për mbrojtje, paditësja kishte kërkuar që asaj dhe dy djemve të saj t’i lejohet shfrytëzimi i një kati të shtëpisë

⁴¹ Neni 9 i Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare. Definicioni i personit në nevojë të cilit duhet t’i ofrohen shërbimet sociale dhe familjare përfshinë çdo person i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të marrëdhënieve të çrregulluara familjare dhe për shkak të dhunës në familje. Shih nenin 1 (3) (e) (4.) dhe (10.) të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

⁴² Neni 14 i Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

⁴³ I pandehuri ishte dënuar me pesë muaj burgim me kusht për një vit nga Gjykata Komunale e Gjilanit/Gnjilane për vepër penale të kërcënimit sipas neneve 161(1) dhe 161 (4) të KPPK-së. Gjykata e kishte mbajtur shqyrtimin kryesor publik më 29 shtator 2006.

⁴⁴ Mbrojtësi i viktimës i cili ishte i pranishëm në seancën gjyqësore ishte pasiv.

së tyre të përbashkët dhe t'i ndalohet burrit të saj për të pasur qasje apo ta kërcënojë atë, ose t'i ndalohet kryerja e ndonjë akti të dhunës në familje ndaj saj apo ndaj fëmijëve të tyre. Për shkak të dështimit të gjykatës për ta thirrur përfaqësuesin e QPS-së në procedurë gjyqësore, në të cilën djali pesëmbëdhjetë vjeçar kishte dëshmuar si dëshmitar i këtij sulmi të supozuar,⁴⁵ përfaqësuesi i QPS-së nuk kishte qenë pranishëm. Andaj, gjykata nuk e kishte pyetur fëmijën se a do të dëshironte të jetonte në të njëjtin vendbanim.

Në një rast në Gjykatën Komunale në Leposavić/Leposaviq, më 13 prill të vitit 2006, gjykata kishte thirrur QPS-në në një seancë të caktuar për 27 prill 2006 për të përfaqësuar njërën nga palët e mbrojtura që gjithashtu kishte qenë fëmijë, në mënyrë që të paraqes mendimin me shkrim se si të veprohet me rastin. QPS-ja kishte rekomanduar me shkrim që i pandehuri të lëshojë shtëpinë e përbashkët, por nuk kishte qenë e pranishme në seancën gjyqësore. Andaj, atë ditë gjykata vendosi mbi kërkesën për urdhër për mbrojtje, që dallonte nga rekomandimi i raportit me shkrim të QPS-së.⁴⁶

Në shembujt e përshkruar më lart, fëmijët viktimat janë përfaqësuar nga nënat e tyre. Është e diskutueshme nëse kjo u ka shërbyer interesave më të mirë të fëmijëve dhe ka respektuar të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar. Për shembull, në rastin e parë nga Gjilani/Gnjilane, nëna dëshironte të kthehej në banesën e bashkëshortit të saj, megjithëse ai e kishte keqtrajtuar atë dhe fëmijën. Pasi që ekzistonte mundësia për dhunë të mëtejshme, është evidente se kthimi në shtëpi nuk është në interesin më të mirë të fëmijës. Ngjashëm, në rastin e dytë (po ashtu nga Gjilani/Gnjilane), nëna dëshironte të kthehej në banesën e bashkëshortit të saj me fëmijët, ndonëse siç pohohej, bashkëshorti kishte kryer akte të dhunës fizike kundër tyre. Përfundimisht, në dy rastet e fundit, as fëmija, e as përfaqësuesi i saj nuk i paraqitën pikëpamjet e fëmijës përkitazi me vendimin adekuat në lidhje me vendimin mbi urdhrin për mbrojtje.

Duke zhvilluar seancat gjyqësore pa praninë e përfaqësuesit të QPS-së, gjykata mund të ketë vepruar në kundërshtim me interesat më të mirë të fëmijës sipas neneve 3 dhe 12 të KDF-së. OSBE-ja rekomandon që gjykatat të informojnë Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale për rastet kur QPS-ja nuk siguron pjesëmarrjen e punëtorëve të vet në seancat gjyqësore kur ata ftohen në mënyrë adekuate për të qenë të pranishëm, ndërkaq nëse është e nevojshme ndaj tyre të iniciohen procedura disiplinore.⁴⁷

C. E drejta për gjykim publik

⁴⁵ Fëmija ishte duke u dridhur dhe duke qarë gjatë dëshmisë, qartë shihej se nuk ndihej rehat të ulej pranë babait të tij.

⁴⁶ Në urdhëresën për mbrojtje të datës 27 prill 2006, gjykata ia ndaloi të pandehurit kryerjen ose kërcënimin se do të kryejë çfarëdo akti të dhunës në familje ndaj palëve të mbrojtura, dhe i lejoi palës paditëse t'i shfrytëzojë të gjitha hapësirat e shtëpisë dhe të shikojë TV.

⁴⁷ Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale i udhëheq dhe i mbikëqyr institucionet e administratës të punës dhe të mirëqenies sociale, ndërsa në bashkëpunim me komunat, zyrat për mirëqenie sociale dhe institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e politikave të punës dhe të mirëqenies sociale, shih Shtojcën VII (vi) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/15 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, 16 mars 2005.

OSBE-ja po ashtu është e brengosur për shkak të mungesës së rregullave të qarta në lidhje me atë nëse duhet ose jo që seancat gjyqësore në rastet e dhunës në familje të jenë publike. Neni 3 i KDF-së parasheh që në procedurat gjyqësore ku përfshihen fëmijët duhet të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës. Në kontekst të publicitetit të procedurave gjyqësore, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës⁴⁸ i nxit shtetet që gjatë procedurave gjyqësore t'i marrin parasysh nevojat dhe shqetësimet e viktimave fëmijë, të cilët i janë nënshtruar dhunës fizike. Prandaj, identiteti i viktimës duhet të jetë konfidencial, ndërkaq herë pas here publiku dhe mediat duhet të përjashtohen nga salla e gjyqimit gjatë procedurave gjyqësore.⁴⁹ Për më tepër, sipas Rekomandimit 1582 (2002) të Këshillit të Evropës mbi *Dhunën në Familje ndaj Grave*, preferohet që dëgjimet për rastet e dhunës në familje të jenë jo-publike.⁵⁰ Vlen të theksohet se përjashtimi i publikut nga disa seanca gjyqësore nuk e shkel nenin 6 të KEDNj-së, e cila parasheh të drejtën për gjykim publik. Kjo e drejtë u nënshtrohet kufizimeve, sipas nenit 6 të KEDNj-së. Për shembull, sipas nenit 6 të KEDNj-së, publiku mund përjashtohet nga i tërë procesi gjyqësor ose nga një pjesë tij, kur një gjë e tillë kërkohet për shkak të interesave të të miturve ose për mbrojtjen e jetës private të palëve.⁵¹

Në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare, ligjet e Kosovës mundësojnë përjashtimin e publikut nga procedura të caktuara gjyqësore, siç janë kontestet martesore, paditë në lidhje me verifikimin e atësisë, kontestet në lidhje me kujdestarinë mbi fëmijën,⁵² dhe në procedura gjyqësore penale në të cilat një vepër penale është kryer ndaj të fëmijës.⁵³ Arsyetimet në lidhje me përjashtimin e publikut në këto raste sipas KEDNj-së, siç është mbrojtja e jetës private dhe e interesave të të miturve me të drejtë aplikohen edhe në rastet e dhunës në familje.

Megjithatë, Rregullorja nuk e trajton çështjen nëse publiku mund të përjashtohet nga procedurat gjyqësore për rastet e dhunës në familje ose nën çfarë kushtesh kjo mund të bëhet. Po ashtu, LPK-ja, e cila zbatohet në rastet e procedurave gjyqësore të dhunës në familje në rastet kur Rregullorja nuk e rregullon çështjen e njëjtë,⁵⁴ nuk lejon përjashtimin e publikut nga procedurat gjyqësore në interes të të miturve dhe me qëllim të mbrojtjes së jetës private.⁵⁵ Përmbledhtazi, duke mbajtur në publik

⁴⁸ Organi i krijuar në bazë të traktatit të OKB-së që mbikëqyr zbatimin e KDF-së.

⁴⁹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Dita e Diskutimit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Fëmijës për t'u Dëgjuar, Rekomandimet, 29 shtator 2006, paragrafi. 50.

⁵⁰ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rekomandimi 1582 (2002), *Masat ligjore që duhet të ndërmerren*, paragrafi. v.

⁵¹ Për shembull, GjEDNj-ja në rastin *P. dhe B. kundër Mbretërisë së Bashkuar* ka konstatuar se në procedurën gjyqësore të kujdestarisë ndaj fëmijës kanë qenë "shembuj parësorë të rasteve ku përjashtimi i shtypit dhe i publikut mund të arsyetohet me qëllim të mbrojtjes së privacisë së fëmijës dhe të palëve si dhe për të evituar paragjykimin e interesit të drejtësisë. Për t'ia mundësuar kryetarit të trupit gjykues që të ketë një pamje sa më të plotë dhe të saktë që është e mundur [...] dhe t'i kontaktojë mendimet në mënyrë të hapur ndaj fëmijës, është qenësore që prindërit dhe dëshmitarët e tjerë të ndjehen në gjendje të shprehin në mënyrë të hapur për çështje thellësisht personale pa pasur frikë nga kureshtja ose komentet (shih *P. dhe B kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj-ja, aktgjykimi, 24 prill 2001, paragrafi. 38).

⁵² Neni 75 dhe 345, E Drejta Familjare.

⁵³ Shih nenet 143(5) dhe 47, Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/8, 20 prill 2004.

⁵⁴ Shih 18.2, Rregullorja

⁵⁵ Neni 307 i LPK-së parasheh përjashtimin e publikut gjatë gjyqimit vetëm nëse kjo është nevojshme për "ruajtjen e sekretit zyrtar, të punës ose personal, interesit të rendit publik, dhe arsytet e moralitetit."

procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me dhunën në familje, gjykatat mund të shkelin parimin e interesit më të mirë të fëmijës, dështojnë në mbrojtjen adekuate të konfidencialitetit për jetën private dhe shpërfillin Rekomandimin e Këshillit të Evropës mbi *Dhunën në Familje ndaj Grave*.

D. Përbërja joadekuate e trupit gjykues

Sipas nenit 5(4) të Rregullores, shqyrtimi i një kërkesë për urdhër për mbrojtje ose një urdhri për mbrojtje emergjente duhet të zhvillohet nga një gjykatës i vetëm. Sidoqoftë, OSBE-ja ka monitoruar procedura gjyqësore ku janë trajtuar raste të dhunës në familje, ku gjyqtarët porotë kanë shërbyer si anëtarë të trupit gjykues:

Në një rast në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priština, dy gjyqtarë porotë kishin shërbyer në një trup gjykues gjatë seancës më 17 nëntor 2006.

Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priština, dy gjyqtarë porotë kishin qenë të pranishëm në një seancë dëgjimore më 4 dhjetor 2006.

Prania e gjyqtarëve porotë si anëtarë të trupit gjykues është në kundërshtim me Rregulloren dhe parandalon praktikën e njëtrajtshme në të gjitha gjykatat që shqyrtimi dhe vendosja për kërkesat që kanë të bëjnë me dhunën në familje të bëhen nga një gjykatës i vetëm. Për më tepër, kjo mund të shkelë të drejtën për gjykim që parashihet me ligj sipas nenit 6 KEDNj-së. Në interpretimin e kësaj të drejte, GjEDNj-ja vendosi që gjykata duhet të ketë përbërje adekuate “në përputhje me ligjin” dhe vuri në dukje se shkelja ndodh kur gjyqi nuk funksionon sipas ligjit të procedurës në fuqi.⁵⁶

E. Arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimeve

Shqetësimi tjetër i identifikuar nga OSBE-ja është arsyetimi i pamjaftueshëm përkitazi me vendimet për urdhrat për mbrojtje në rastet e dhunës në familje. Kjo shkel ligjin në fuqi dhe shkel të drejtën e palëve për gjykim të drejtë.

Sipas rasteve nga praktika gjyqësore e GjEDNj-ja, kushti për vendim të arsyetuar në rastet civile dhe penale nënkuptohet me të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNj-së. Kërkesa për aktgjykim të arsyetuar është e një rëndësie të veçantë, ashtu që pala të mund të ushtrojë të drejtën e ankesës, pasi që nëse mungojnë arsyet që e arsyetojnë një vendim të gjykatës, pala ankuese nuk mund ta sfidojë si duhet vendimin e gjykatës më të ulët.⁵⁷

Rregullorja kërkon që “[...] gjykata të nxjerrë një urdhër për mbrojtje [...] nëse konstaton se: ka bazë për të besuar se pala përgjegjëse ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë një akt të dhunës në familje; ndërkaq nxjerrja e urdhrit për mbrojtje është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur.”⁵⁸ Në Rregullore paraqiten elementet qenësore që duhet t’i përmbajë një urdhër për

⁵⁶ Shih *Zand kundër Italisë*, Raporti i Komisionit nr. 7360/76, 1978 dhe *Rossi kundër Francës*, Raporti i Komisionit nr. 11879/85, 1989.

⁵⁷ Shih *Suominen kundër Finlandës*, GjEDNj, aktgjykimi, 24 korrik 2003, paragrafët. 34-38.

⁵⁸ Neni 8(1) (a) (b) i Rregullores.

mbrojtje (siç janë masat specifike mbrojtëse, kohëzgjatja, shkelja paraqet vepër penale, dhe e drejta e ankimit).⁵⁹ Për më tepër, edhe në LPK thuhet se aktgjykimi i plotfuqishëm duhet të përmbajë shpjegimin që përfshin faktet dhe provat mbi të cilat bazohet ajo urdhëresë.⁶⁰

Pavarësisht këtyre dispozitave të së drejtës vendore dhe standardeve ndërkombëtare, OSBE-ja ka monitoruar raste ku vendimet e gjykatës mbi urdhrat për mbrojtje nuk janë arsyetuar.

Në një rast të dhunës në familje në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane në të cilën pala e mbrojtur kishte kërkuar urdhër për mbrojtje më 29 shtator 2006, gjykata ka nxjerrë një urdhër për mbrojtje më 13 tetor 2006, në të cilën cekeshin masat e urdhëruara pa asnjë shpjegim ose arsyetim.

Në një shembull të dytë në Gjykatën Komunale të Pejës/Peć, gjykatësi kishte nxjerrë një urdhër për mbrojtje më datën 24 nëntor 2006 pa asnjë shpjegim ose arsyetim.⁶¹

Në një rast tjetër të dhunës në familje para Gjykatës Komunale të Pejës/Peć, gjykata kishte lëshuar një urdhër për mbrojtje më 4 shtator 2006. Në atë urdhër ceket se urdhri për mbrojtje është i bazuar sipas Rregullores së UNMIK-ut,⁶² duke mos iu referuar fakteve të rastit ose shpjegimit të mëtejshëm.

Në një shembull tjetër në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priştina, gjykata në urdhrin për mbrojtje emergjente të datës 20 nëntor 2006, kishte cekur se urdhri është i nevojshme për mbrojtjen e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies të palës së mbrojtur. Gjukata kishte vënë në dukje se ka arsye për të besuar që pala përgjegjëse ka kryer një akt të dhunës në familje, duke mos përmendur faktet ose shpjegimin e arsyeve për këtë vendim.

Në disa raste të dhunës në familje në Gjykatën Komunale të Mitrovicës/Mitrovica, gjykatësi kishte lëshuar urdhra për mbrojtje⁶³ në të cilat është cekur se urdhrat janë të nevojshme për të mbrojtur mirëqenien dhe shëndetin e palëve të mbrojtura. Vendimet nuk iu janë referuar fakteve të rastit ose dëshmimeve tjera për t'i bazuar konstatimet e saj.

Këto raste shkelin kërkesat e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare për të marrë vendime të arsyeshme. E drejta për gjykim të drejtë përfshin të drejtën për marrjen e vendimit të arsyetuar. Për më tepër, mungesa e vendimit të arsyetuar e pengon

⁵⁹ Neni 8(3), Rregullorja.

⁶⁰ Shih neni 338(1) i LPK-së. Në bazë të nenit 18(2), të Rregullores., “[] duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore kur nuk janë saktësuar në Rregullore si procedurë e posaçme kontestimore.”

⁶¹ Përveç dëgjimit të parashtruesit të kërkesës dhe ndihmësit të viktimës, gjykata nuk kishte pasur asnjë burim tjetër provash. Jo vetëm kaq, i pandehuri nuk kishte qenë i pranishëm në seancë dëgjimore dhe nuk mund ta mbronte veten (shtrohen çështje të tjera për gjykim të drejtë). Gjukata nuk kishte prova të tjera përveç dëshmisë së paditësit dhe ndihmësit të viktimës për të arritur gjetjen e dyshimit të arsyeshëm se pala përgjegjëse ka kryer një akt të dhunës në familje.

⁶² Gjukata i është referuar nenit 8(3) (b), të Rregullores .

⁶³ Të datave 11 prill 2006, 21 korrik 2006, 15 shtator 2006 dhe 27 shtator 2006.

mundësinë për ankim ndaj vendimit të tillë dhe mund të shkel të drejtën për shfrytëzim të mjeteve efektive juridike.

F. Problemet me ankesat: mosekzekutimi i urdhrave për mbrojtje dhe afatet e paqarta për parashtrim të ankesës

Një nga elementet më të rëndësishme për një drejtësi të drejtë është ekzistimi i një procedure efektive për ekzekutimin e aktgjykimeve të plotfuqishme. E drejta për gjykim të drejtë është e mangët nëse nuk zbatohen vendimet e gjyqit.⁶⁴

Në përgjithësi, ekzekutimi i vendimeve të gjykatave rregullohet me Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore⁶⁵. Veç kësaj, Rregullorja parashih që personi i cili e shkel urdhërin për mbrojtje dënohet me gjobë nga 200 deri në 2000 euro ose me burg deri në gjashtë muaj.⁶⁶ Sipas Rregullores, parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.⁶⁷

Megjithatë, OSBE-ja ka monitoruar raste, ku gjykata ka cekur gabimisht në urdhrin për mbrojtje se ankesa do të ndalonte ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

Në një rast, në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, gjykata kishte lëshuar një urdhër për mbrojtje më 13 tetor 2006, në të cilën thuhej se ankesa e ndalon ekzekutimin. Pas lëshimit të urdhrin për mbrojtje nga gjykata më 24 tetor 2006, i akuzuari ishte ankuar ndaj këtij vendimi më 31 tetor 2006. Pas ankesës, Gjykata e Qarkut në Gjilan/Gnjilane ka mbështetur urdhër për mbrojtje më 6 dhjetor 2006. Ndonëse në këtë datë, vendimi i gjykatës më të ulët më në fund ka qenë i gatshëm për ekzekutim, dhe deri në atë kohë shtëpia e cila i ishte nënshtruar urdhrin për mbrojtje i ishte shitur palës së tretë.⁶⁸

Në rastin e dytë në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane, gjykatësi kishte lëshuar një urdhër për mbrojtje më 26 shkurt 2006 në të cilën thuhej se ankesa e ndalon ekzekutimin e tij.

Vendimi i paligjshëm për të ndaluar urdhrin për mbrojtje pas ankesës, përbën shkelje të Rregullores dhe me gjasë edhe të së drejtës ndërkombëtare dhe rrezikon shëndetin dhe sigurinë e palës së mbrojtur.

⁶⁴ E drejta për të parashtruar kërkesë para gjykatës lidhur me të drejtat dhe obligimet civile do të ishte iluzore nëse vendimi i plotfuqishëm i gjykatës do të ishte jofunksional në dëm të një pale. Shih aktgjykimin e GjEDNJ-së në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, ku Gjykata ka deklaruar se “[do] të ishte e papërfytyrueshme që neni 6(1) [i KEDNJ-së] të përshkruante në hollësi garancitë procedurale të cilat u ofrohen nga palëve në procedurën gjyqësore – procedurat gjyqësore që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore.” Shih aktgjykimin e GjEDNJ-së *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997, paragrafi 40.

⁶⁵ Shih neni 1(1) i Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78 (LPP)

⁶⁶ Neni 15 i Rregullores.

⁶⁷ Neni 11(2) i Rregullores.

⁶⁸ I pandehuri pastaj, më 16 shkurt 2007, është gjobitur me 200 euro nga Gjykata Komunale e Gjilanit/Gnjilane për shkeljen e urdhëresës për mbrojtje. Në të njëjtën datë, pala e mbrojtur ka parashtruar kërkesë për ndryshimin e urdhëresës për mbrojtje i cili ishte refuzuar nga gjykata më 13 mars 2007. Ky vendimi është ende nën procedurën ankimore.

Përveç problemit të vonësive në ekzekutimin e aktgjykimeve, OSBE-ja ka vërejtur që Rregullorja përmban dispozita kundërthënëse evidente lidhur me afatin përfundimtar për parashtrimin e ankesës nga marrja e vendimit mbi kërkesën për lëshimin e urdhrit për mbrojtje.

Sipas nenit 8(3) d) të Rregullores, në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket “njoftimi për të drejtën e ankesës kundër urdhrit për mbrojtje brenda tetë ditëve nga marrja e këtij vendimi.” Për dallim nga kjo, neni 11(1) i Rregullores cekë se ankesa kundër vendimit mbi kërkesën për urdhër për mbrojtje duhet të parashtrohet brenda tetë ditëve, nga dita e lëshimit të këtij vendimi. Prandaj, është e paqartë nëse afati prej tetë ditësh duhet të filloj nga marrja e urdhrit për mbrojtje ose që nga data e lëshimit të tij. Ndonëse, urdhri për mbrojtje duhet t’i dorëzohet të paditurit menjëherë pas lëshimit të tij, këto të dyja mund të mos ndodhin njëkohësisht. Nën dritën e dykuptimisë së përkitazi me afatin përfundimtar për parashtrimin e ankesës ndaj lëshimit të urdhrit për mbrojtje, Rregullorja do të duhej ndryshohet nga autoritetet ligjvënëse.

G. Dështimi i autoriteteve për të ndjekur penalisht veprat që paraqiten nga dhuna në familje

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), kërkon që “[prokurori] publik të fillojë hetimin [...] nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se personi ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).”⁶⁹ Veç kësaj, autoritetet mund t’i shkulin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, nëse nuk tregojnë kujdes të duhur në hetimin dhe dënimin e veprave penale.⁷⁰

Që nga hyrja në fuqi e Rregullores, vepra penale e shkaktimit të lëndimit të lehtë trupor e kryer në kontekst të marrëdhënies familjare duhet të ndiqet automatikisht, d.m.th. pavarësisht nëse këtë e kërkon pala e dëmtuar apo jo.⁷¹ Arsyeja për këtë është e dyfishtë. Së pari, për të siguruar që autoritetet publike, përfshirë prokurorin të mos i lënë pa dënuar veprat e dhunshme penale të kryera në kontekst të marrëdhënies

⁶⁹ Shih nenet 6(3) dhe 220(1) të KPPPK-së.

⁷⁰ Komenti i Përgjithshëm nr. 31, të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Natyra e Obligimeve të Përgjithshme Ligjore të Vëna mbi Shtetet që janë Palë të Konventës, 26 maj 2004 (CCPR/C/21/Rev.1/Add.13), paragrafi 8. Në vrojtimet përfundimtare mbi raportin shtetëror të Republikës së Moldavisë, Komiteti mbi Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave thekson se dhuna ndaj grave, “duke përfshirë dhunën në familje përbën shkelje të të drejtave të njeriut të grave sipas Konventës”. Kjo i bën thirrje Qeverisë “që të siguroj që dhuna e tillë përbën veprë penale që dënohet sipas ligjit penal, që të ndiqet penalisht dhe të dënohet me ashpërsi dhe shpejtësi të duhur” (*Raporti i Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave*, seanca e 22-të dhe 23-të, dokument i OKB-së A/55/38, 17 gusht 2000, paragrafi 102). Komiteti gjithashtu ka nxitur Uzbekistanin që të siguroj që gratë dhe vajzat, të cilat janë viktime të dhunës, duke përfshirë dhunën në familje, “të kenë mjete të menjëhershme të rregullimit dhe mbrojtjes” (*Raporti i Komitetit*, seanca e 24-të, dokument i OKB-së A/56/38, 20 prill 2001, paragrafi 177).

⁷¹ Rregullorja kërkon ndjekje sipas detyrës zyrtare të veprës penale të shkaktimit të lëndimit të lehtë trupor (neni 16(2)), që ndryshon ligjin mëparshëm në fuqi, sipas të cilit kjo veprë penale mund të ndiqet vetëm nëse këtë e kërkon pala e dëmtuar. Sipas KPPK-së, më nuk kërkohet kërkesa nga pala e dëmtuar për ndjekjen e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor (shih. nenin 153, KPPK). Thënë shkurt, që nga hyrja në fuqi e Rregullores, prokurori duhet të ndjekë sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) veprat penale të lëndimit të lehtë trupor. Vlen të përmendet se KPPK-ja ka rivënë në zbatim kërkesën për ndjekje penale të veprës penale të “dëmtimit të pasurisë së luajtshme” (shih nenet 260 dhe 275 të KPPK-së), rrjedhimisht duke e zëvendësuar dispozitën e kundërt të Rregullores (neni 16(3)).

familjare. Së dyti, të lirohet viktima nga ngarkesa shtesë për të vendosur se a të iniciojë ndjekjen penale apo jo.⁷²

Përkundër kërkesave të qarta ligjore të Rregullores dhe KPPPK-së, OSBE-ja ka bërë monitorimin e disa rasteve, ku personat të cilët me gjasë kanë kryer veprën penale të shkaktoimit të lëndimit të lehtë trupor gjatë marrëdhënies familjare, nuk janë ballafaquar me ndjekjen penale.⁷³

Në një rast në Ferizaj/Uroševac, më 20 nëntor 2006, Prokurori Publik Komunal e ka hedhë poshtë kallëzimin penal të policisë⁷⁴ të datës 3 nëntor 2006 që tregonte se burri e kishte sulmuar fizikisht gruan e tij dhe i kishte shkaktoar lëndime, si rrjedhim ka kryer veprën penale që duhet të ndiqet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Sipas hetimit të policisë, ka pasur dhunë ndërmjet çiftit edhe para ndodhjes së këtij incidenti.⁷⁵ Në vendimin mbi hedhjen poshtë të kallëzimit, prokurori e ka interpretuar gabimisht legjislacionin aktual në fuqi dhe ka pohuar që të dyja palët kanë kryer “dhunë në familje”, një veprën penale që nuk ekziston. Veç kësaj, në vendimin mbi hedhjen poshtë të kallëzimit ceket se “vepra penale [e dhunës në familje] nuk radhitet në mesin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).”⁷⁶

Në një rast tjetër në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës/Mitrovica, më 23 mars 2007 prokurori ka hedhë poshtë një raport policor i cili kishte të bënte me një rrahje të supozuar të fëmijës me shkop nga babai i saj.⁷⁷ Në vendimin mbi hedhjen poshtë të raportit policor, prokurori pa të drejtë kishte cekur që në veprimet e të pandehurit nuk ka asnjë element të ndonjë veprë penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare.

Në rastet e përshkruara më lart, mungesa e raportit mjekësor e bën të vështirë të përcaktohet se a ka mjaft dëshmi për ekzistim të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor. Policia nuk i ka sjellë me kohë prokurorit të gjitha dëshmitë e nevojshme për të bërë ndjekjen e një veprë të mundshme penale. Sidoqoftë edhe prokurori nuk është treguar i kujdesshëm në veprimet hetuese përgatitore duke mos mbledhur të gjitha provat e nevojshme. Si pasojë, personi i cili ka gjasa të ketë qenë i përfshirë në veprën penale nuk është përballur me drejtësinë.

⁷² Gjithashtu, pala e dëmtuar nuk duhet të jetë e cënueshme ndaj presionit dhe frikësimit nga kryerësi dhe/ose familjes së tij/saj.

⁷³ Zyrtarët policor të intervistuar nga OSBE-ja kanë sugjeruar se një prej arsyeve për mosndjekje penale është se palët pajtohen dhe që nga prokurori publik nuk ngriten aktakuza. Megjithatë, sipas KPPPK-së, prokurori nuk mund të ketë vlerësim të lirë për të mos i zhvilluar ndjekjet penale. Prokurori mund ta hedhë poshtë kallëzimin penal ose t'i ndërpres hetimet vetëm kur shfaqen kushte të veçanta ligjore (shih nenet 208 dhe 224 të KPPPK-së). Në rastet e dhunës në familje, KPPPK-ja nuk i ofron prokurorit mundësinë për të iniciuar ose hequr dorë nga ndjekja penale, pasi që kur kryhet vepra penale e lëndimit të lehtë trupor në kontekst të marrëdhënieve familjare, ajo është e dënueshme me burgim nga gjashtë muaj deri në tri vjet, që është shumë më tepër se kufizimi prej një viti që parashihet në nenin 227. Në mënyrë të ngjashme, prokurori publik nuk mund t'i pezullojë hetimet në bazë të nenit 226, pasi që paragrafi 5 shprehimisht cekë se ky mekanizëm nuk zbatohet për dhunën në familje. Në fund, procedura e ndërmjetësimit sipas nenit 228 të KPPPK-së mund të aplikohet, por duhet të zbatohet nga një ndërmjetësues i pavarur, e jo nga prokurori publik.

⁷⁴ Shih nenin 208 të KPPPK-së.

⁷⁵ Dosja e rastit nuk përmban certifikatë mjekësore ose ndonjë kërkesë për një dokument të tillë.

⁷⁶ Përkthim jozyrtar i OSBE-së i pjesës përkatëse të vendimit të prokurorit më 20 nëntor, 2006.

⁷⁷ Sërish, dosja nuk përmbante asnjë raport mjekësor.

Po ashtu, OSBE-ja ka monitoruar raste ku autoritetet kanë lëshuar urdhra për mbrojtje në përputhje me Rregulloren, në vend se të bëjnë hetime dhe kur është nevoja, të ndjekin veprën penale të lëndimit trupor.

Në një rast pranë autoriteteve në Pejë, në shkurt të vitit 2007 policia i ka paraqitur organeve të ndjekjes një dosje të incidenteve të dhunës në familje ku një viktimë femër kishte pësuar lëndime të dukshme trupore. Prokuroria publike nuk ka mundur ta gjejë rastin në regjistrin e saj të dosjeve. Si pasojë, prokurori asnjëherë nuk e kishte hetuar apo ndjekur këtë vepër të mundshme penale.⁷⁸ Në vend të kësaj, gjykata komunale kishte lëshuar një urdhër për mbrojtje kundër burrit të viktimës.

Në një rast në vitin 2004, që ishte trajtuar nga autoritetet në Leposaviq/Leposaviq, i cili kishte të bënte me dhunën në familje dhe i cili kishte rezultuar me lëndime të dukshme në fytyrën e një gruaje, dosja e policisë ishte dërguar në prokurori. Edhe në këtë rast, prokurori asnjëherë nuk ka iniciuar hetimet pasi që rasti nuk gjendej në regjistrin e tij të ndjekjeve.

Urdhri për mbrojtje nuk e zëvendëson ndjekjen penale e cila vazhdon të mbetet detyrim i prokurorit. Prandaj dështimi për të bërë ndjekjen penale të veprave të caktuara (duke përfshirë lëndimin e lehtë trupor), të kryera në kontekst të marrëdhënieve familjare, përbën shkelje të së drejtës vendore dhe standardeve ligjore ndërkombëtare.

IV. KONKLuzion

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Rregullorja përcakton një procedurë civile përmes së cilës viktimat e dhunës në familje mund të kërkojnë nga gjykata që të lëshojnë urdhër për mbrojtje. Megjithatë, kjo Rregullore nuk është e qartë në disa fusha të caktuara dhe nganjëherë gjyqtarët nuk i respektojnë dispozitat e kësaj Rregullore.

OSBE-ja ka vërejtur disa vonesa të paligjshme në procedurën e vendosjes për urdhrat e mbrojtjes ose në procedurën e caktimit të seancave. Ka pasur edhe të meta të tjera ku viktimat e supozuara apo dëshmitarët kanë qenë fëmijët dhe është vërejtur mungesa e rregullave të qarta në Rregullore sa i përket asaj se a duhet që seancat të jenë publike apo jo. Të metat tjera që janë vërejtur kanë të bëjnë me përbërjen joadekuate të trupit gjykues, arsyetim të pamjaftueshëm të vendimeve gjyqësore, dhe probleme me procedurat e ankimit. Përfundimisht, OSBE-ja është shumë e brengosur për dështimin e prokurorëve në ndjekjen veprave të caktuara penale të cilat ndodhin në kontekst të marrëdhënieve familjare. Këto mangësi paraqesin shumë probleme posaçërisht kur rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e palës së mbrojtur.

⁷⁸ Në disa raste të cilat janë trajtuar në vitin 2003 dhe 2004 nga autoritetet në Pejë/Pec, policia ka dërguar dosjet që kishin të bënin me dhunën në familje drejtpërsëdrejti në gjykatën kompetente komunale. Megjithatë, nuk ka asgjë në zyrën e prokurorit që tregon se është bërë ndonjë hetim apo vendim për ndërprerje të hetimeve. Në një rast, raporti mjekësor tregonte se viktimës i ishin shkaktuar lëndime të rënda në dorën e majtë dhe në hundë. Ndjekja e këtyre veprave penale tani është e paraparë sipas ligjit në fuqi (neni 90 i KPPK-së që lidhet me nenin 153 KPPK-së).

V. REKOMANDIME

Për Legjislativin:

- Rregullorja duhet të ndryshohet për të qartësuar që përfaqësuesit e QPS-së duhet të dëgjohen në procedurat e dhunës në familje, kur në to janë të përfshirë të fëmijët.
- Në rregullore duhet të qartësohet afati përfundimtar për dorëzimin e ankesave.

Për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë:

- Kur të vendosin për kërkesat për urdhër për mbrojtje, gjyqtarët duhet të veprojnë në përputhshmëri me ligjin përkatës dhe të vendosin për kërkesat brenda afateve të përcaktuara kohore.
- Gjyqtarët duhet të arsyetojnë në mënyrë adekuate vendimet e tyre në rastet e dhunës në familje, përmes vendimeve të qarta dhe të arsyetuara mirë me referencë në fakte të rastit.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë prezencën e përfaqësuesit të QPS-së në procedurat që kanë të bëjnë me dhunën në familje kur njëra nga palët e mbrojtura është i mitur.
- Prokurorët duhet të hetojnë rastet shpejtë dhe nëse është e nevojshme të ndjekin me kujdes të duhur personat të cilët mund të kenë kryer vepra penale siç janë lëndimi i lehtë trupor, në kontekst të dhunës në familje.
- Prokurorët dhe policia duhet të sigurojnë që çdo raport mjekësor i cili tregon se viktima e dhunës në familje ka pësuar lëndime fizike të renditet dhe të përfshihet në raportet policore të cilët i përcillen prokurorit.
- Pavarësisht se a është lëshuar apo jo urdhri për mbrojtje, policia dhe prokurori duhet të sigurojnë ndjekje kurdo që shihet se është kryer një vepër e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) në kontekst të marrëdhënieve familjare.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të trajtojë gjyqtarët dhe prokurorët përkitazi me ligjet në fuqi në rastet e dhunës në familje, përfshirë edhe Rregulloren, KEDNG-në dhe KDF-në.

Për Qendrat për punë sociale:

- QPS-të duhet t'u përgjigjen thirrjeve të gjykatës dhe të marrin pjesë në seancat që kanë të bëjnë me dhunën në familje, për të siguruar ekspertizën e tyre, mendimet e ekspertëve dhe raportet.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të sigurojë që QPS-të t'u përgjigjen thirrjeve të gjykatës në rastet e dhunës në familje dhe të sigurojë trajnim për QPS-të mbi KDF-në.